



Data	
Nr. Prot	

RELACION

VENDIMI

PËR

SHOYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. EULAND HAKI DAJA, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË SHIJAK, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA DEMOKRATIKE”, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati /Anëtari në Këshillin e Bashkisë”.

Z. Euland Haki Daja, është propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” si kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Për këtë kandidat më datë 29.3.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik DR-PDSH-8603. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e

vetëdeklarimit të z. Euland Haki Daja, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit:

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Euland Haki Daja, rezulton se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.
- b) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Euland Haki Daja, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

II

Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për të kandiduar, janë verifikuar të dhëna të tjera në formularin e vetëdeklarimit të z. Euland Haki Daja, ku rezultoi se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se është proceduar nga Gjykata e Bazelit, Zvicër, dënim me 10 muaj burgim, duke mos deklaruar numrin e vendimit të gjykatës.
- Pyetjes 3 “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj , për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se është proceduar nga Prokuroria Bazel Zvicër në vitin 1998-1999. Subjekti nuk ka deklaruar veprën penale dhe masën e dënimit;
- Pyetjes 4 “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se është proceduar nga Prokuroria Bazel Zvicër në vitin 1998-1999. Subjekti nuk ka deklaruar veprën penale dhe masën e dënimit;
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se ka jetuar si emigrant në Bazel, Zvicër nga viti 1998-1999, si dhe në Venezia, Itali nga viti 2018-2019.

Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr.4089., datë 24.04.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 612/41 prot.extra 23, datë 11.09.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Euland Haki Daja”, Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatin e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Euland Haki Daja, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile por rezulton të ketë përdorur gjeneralitete të tjera përveç atyre të vetëdeklaruar, me emrin TAULAND;
- Rezulton të jetë dënuar me 16 muaj burgim, pezulluar me kusht për dy vjet, me vendim të formës së prerë të datës 14 prill 1999, nga Gjykata Penale Basel -Qytet Zvicër për kryerje të veprës penale të shitjes /tregtimit të lëndëve narkotike, parashikuar nga neni 19 dhe në vijim shifra 1 dhe 2 të ligjit për Lëndët Narkotike (të Zvicrës) si dhe 41 shifra 1, 55 paragrafi 1 dhe 69 i Kodit Penal (të Zvicrës). Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë veprat e këtij të pandehuri parashikohen aktualisht në nenin 283, paragrafi 2;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të jetë hetuar, nga Prokuroria Basel-Qytet, Zvicër , në kuadër të procedimit penal nr. 257 13/98, për kryerje të veprës penale të shitjes /tregtimit të lëndëve narkotike, parashikuar në nenin neni 19 e në vijim shifra 1 dhe 2 të Ligjit për Lëndët Narkotike (të Zvicrës) si dhe 41 shifra 1, 55 paragrafi 1 dhe 69 i Kodit Penal (të Zvicrës) dhe si shkelës i Ligjit Federal të Qëndrimit dhe Banimit të shtetasve të huaj 91-1, qëndrim ilegal dhe 2-mosrespektim i kufizimit të lëvizjes , dërguar për gjykim më datë 14 dhjetor të vitit 1998, dhe gjykuar nga Gjykata Penale Basel-Qytet me vendimin e datës 14 prill 1998;
- Rezulton të jetë ndaluar më datë 17.10.1998, nga Departamenti i Policisë dhe Ushtrisë së Kantonit Basel-Qytet Zvicër, si i dyshuar për shkeljen e ligjit zvicerian për lëndët narkotike ANA neni 23 paragrafi 1, dhe masave EWD (rrezik largimi);
- Rezulton të jetë caktuar ndaj tij, masa shtrënguese e sigurisë personale “Arrest në Burg” me afat për shkeljen e ligjit zvicerian për lëndët narkotike, nga Gjykata Basel-Qytet Zvicër, me vendimet datë 20.10.1998 dhe datë 17.11.1999;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë veprë penale;
- Rezulton të jetë marrë për të masa e dëbimit për një *periudhë dhjetë vjecare*, nga Gjykata Penale Basel-Qytet, Zvicër, me vendimin penal të datës 14 prill 1999, për cënim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike të shtetit të Zvicrës, për shak të kryerjes në këtë vend të veprës penale të shitjes/tregtimit të lëndëve narkotike;

- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
 - për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
 - dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve të tjera.

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).

Nga shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se z. **Euland Haki Daja**, në bazë të vendimit të formës së prerë të datës 14 prill 1999, të Gjykatës Penale të Basel-Qytet Zvicër, rezulton të jetë dënuar me 16 muaj burgim, pezulluar me kusht për dy vjet, për kryerje të veprës penale të shitjes /tregtimit të lëndëve narkotike, parashikuar nga neni 19 dhe në vijim shifra 1 dhe 2 të ligjit për Lëndët Narkotike (të Zvicrës) si dhe 41 shifra 1, 55 paragrafi 1 dhe 69 i Kodit Penal (të Zvicrës). Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë veprat e këtij të pandehuri parashikohen aktualisht në nenin 283, paragrafi 2.

Referuar shkronjës a, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88 paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278 paragrafin e parë, të pestë e të gjashtë, 278/a, 282/a, 283, **283/a**, 284/a, 287 i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal.

Vepra penale “Trafikimi Narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a, i Kodit Penal, përfshihet, në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar nga neni 2, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr.138/2015.

Z. Euland Haki Daja, gjithashtu nuk ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit gjeneralitetet e tjera të përdorura prej tij, që sipas rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm rezultojnë të ketë përdorur emrin **TAULAND**.

Nga dokumentacioni i përcjellë, konkludohet se, subjekti nuk ka deklaruar gjeneralitete të tjera të mëparshme të përdorura prej tij, gjë që bie ndesh me pikën 3, shkronja “ç”, të Kreut III të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit parashikohet se: *...pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në të, passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik”*.

Subjektet mbajnë përgjegjësinë e plotë dhe janë të vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota dhe të pasakta, në lidhje me të kaluarën e tyre.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 578, datë 24.05.2023, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, për Këshillin e Bashkisë Shijak, qarku Durrës, dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14.05.2023. Partia Demokratike ka fituar 2 (dy) mandate dhe z. Euland Haki Daja, kandidat i listës shumëmemërore të Partisë Demokratike në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14.05.2023, Këshilli i Bashkisë Shijak, qarku Durrës, nuk ka marrë mandatin e anëtarit të këshillit të bashkisë. Duke qenë se subjekti, Partia Demokratike, ka marrë 2 (dy) mandate në Këshillin e Bashkisë Shijak, Qarku Durrës, kandidati z. Euland Haki Daja, i renditur në listë me numrin rendor 10 (dhjetë), potencialisht mund të përfitojë mandatin e anëtarit të këshillit për këtë legjislaturë.

Nga shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson se kandidati për anëtar këshilli, z. Euland Haki Daja, referuar pikës 3, shkronjës “ç”, Kreut III të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, neni 2, pika 1, shkronja “a” dhe neni 4, pika 1 e ligjit 138/2015 është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes ose emërimit në funksion publik.

Pavlina DOÇAJ	-Shef i Sektorit të Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit
Jona JOSIFI	-Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
Madalena KOJA	-Drejtorja e Ligjshmërisë
Majlinda ÇELMETA	-Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data:

Nr:

Ora:

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. EULAND HAKI DAJA, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË SHIJAK, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA DEMOKRATIKE”, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 10.2024, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Euland Haki Daja kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Palë të interesuara: Z. Euland Haki Daja, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Data: 9.2024 Nr:
Ora:



“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Euland Haki Daja, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike”

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati /Anëtari në Këshillin e Bashkisë”.

Z. Euland Haki Daja, është propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” si kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Për këtë kandidat më datë 29.3.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik DR-PDSH-8603. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Euland Haki Daja, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit:

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Euland Haki Daja, rezulton se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.
- b) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Euland Haki Daja, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

II

Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për të kandiduar, janë verifikuar të dhëna të tjera në formularin e vetëdeklarimit të z. Euland Haki Daja, ku rezultoi se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se është proceduar nga Gjykata e Bazelit, Zvicër, dënim me 10 muaj burgim, duke mos deklaruar numrin e vendimit të gjykatës.
- Pyetjes 3 “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se është

- proceduar nga Prokuroria Bazel Zvicër në vitin 1998-1999. Subjekti nuk ka deklaruar veprën penale dhe masën e dënimit;
- Pyetjes 4 “ A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se është proceduar nga Prokuroria Bazel Zvicër në vitin 1998-1999. Subjekti nuk ka deklaruar veprën penale dhe masën e dënimit;
 - Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj ?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se ka jetuar si emigrant në Bazel, Zvicër nga viti 1998-1999, si dhe në Venezia, Itali nga viti 2018-2019.

Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr.4089., datë 24.04.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 612/41 prot.extra 23, datë 11.09.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “*Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Euland Haki Daja*”, Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. *Euland Haki Daja*, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile por rezulton të ketë përdorur gjeneralitete të tjera përveç atyre të vetëdeklaruar, me emrin TAULAND;
- Rezulton të jetë dënuar me 16 muaj burgim, pezulluar me kusht për dy vjet, me vendim të formës së prerë të datës 14 prill 1999, nga Gjykata Penale Basel -Qytet Zvicër për kryerje të veprës penale të shitjes /tregtimit të lëndëve narkotike, parashikuar nga neni 19 dhe në vijim shifra 1 dhe 2 të ligjit për Lëndët Narkotike (të Zvicrës) si dhe 41 shifra 1, 55 paragrafi 1 dhe 69 i Kodit Penal (të Zvicrës). Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë veprat e këtij të pandehuri parashikohen aktualisht në nenin 283, paragrafi 2;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të jetë hetuar, nga Prokuroria Basel-Qytet, Zvicër , në kuadër të proçedimit penal nr. 257 13/98, për kryerje të veprës penale të shitjes /tregtimit të lëndëve narkotike, parashikuar në nenin neni 19 e në vijim shifra 1 dhe 2 të Ligjit për Lëndët Narkotike (të Zvicrës) si dhe 41 shifra 1, 55 paragrafi 1 dhe 69 i Kodit Penal (të Zvicrës) dhe si shkelës i Ligjit Federal të Qëndrimit dhe Banimit të shtetasve të huaj 91-1, qëndrim ilegal dhe 2-mosrespektim i kufizimit të lëvizjes , dërguar për gjykim më datë 14 dhjetor të vitit 1998, dhe gjykuar nga Gjykata Penale Basel-Qytet me vendimin e datës 14 prill 1998;
- Rezulton të jetë ndaluar më datë 17.10.1998, nga Departamenti i Policisë dhe Ushtrisë së Kantonit Basel-Qytet Zvicër, si i dyshuar për shkeljen e ligjit zvicerian për lëndët narkotike ANA neni 23 paragrafi 1, dhe masave EWD (rrezik largimi);

- Rezulton ti jetë caktuar ndaj tij, masa shtrënguese e sigurisë personale “Arrest në Burg” me afat për shkeljen e ligjit zvicerian për lëndet narkotike, nga Gjykata Basel-Qytet Zvicër, me vendimet datë 20.10.1998 dhe datë 17.11.1999;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Rezulton të jetë marrë për të masa e dëbimit për një *periudhë dhjetë vjecare*, nga Gjykata Penale Basel-Qytet, Zvicër, me vendimin penal të datës 14 prill 1999, për cënim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike të shtetit të Zvicrës, për shak të kryerjes në këtë vend të veprës penale të shitjes/tregtimit të lëndëve narkotike;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
 - për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
 - dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve të tjera.

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).

Nga shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se z. **Euland Haki Daja**, në bazë të vendimit të formës së prerë të datës 14 prill 1999, të Gjykatës Penale të Basel-Qytet Zvicër, rezulton të jetë dënuar me 16 muaj burgim, pezulluar me kusht për dy vjet, për kryerje të veprës penale të shitjes /tregtimit të lëndëve narkotike, parashikuar nga neni 19 dhe në vijim shifra 1 dhe 2 të ligjit për Lëndët Narkotike (të Zvicrës) si dhe 41 shifra 1, 55 paragrafi 1 dhe 69 i Kodit Penal (të Zvicrës). Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë veprat e këij të pandehuri parashikohen aktualisht në nenin 283, paragrafi 2.

Referuar shkronjës a, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88 paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/ç, 231, 232,

232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278 paragrafin e parë, të pestë e të gjashtë, 278/a, 282/a, 283, **283/a**, 284/a, 287 i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal.

Vepra penale “Trafikimi Narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a, i Kodit Penal, përfshihet, në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar nga neni 2, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr.138/2015.

Z. Euland Haki Daja, gjithashtu nuk ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit gjeneralitetet e tjera të përdorura prej tij, që sipas rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm rezulton të ketë përdorur emrin **TAULAND**.

Nga dokumentacioni i përcjellë, konkludohet se, subjekti nuk ka deklaruar gjeneralitete të tjera të mëparshme të përdorura prej tij, gjë që bie ndesh me pikën 3, shkronja “ç”, të Kreut III të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit parashikohet se:....*pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në të, passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik*”.

Subjektet mbajnë përgjegjësinë e plotë dhe janë të vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota dhe të pasakta, në lidhje me të kaluarën e tyre.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 578, datë 24.05.2023, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, për Këshillin e Bashkisë Shijak, qarku Durrës, dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14.05.2023. Partia Demokratike ka fituar 2 (dy) mandate dhe z. Euland Haki Daja, kandidat i listës shumëmemërore të Partisë Demokratike në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14.05.2023, Këshilli i Bashkisë Shijak, qarku Durrës, nuk ka marrë mandatin e anëtarit të këshillit të bashkisë. Duke qenë se subjekti, Partia Demokratike, ka marrë 2 (dy) mandate në Këshillin e Bashkisë Shijak, Qarku Durrës, kandidati z. Euland Haki Daja, i renditur në listë me numrin rendor 10 (dhjetë), potencialisht mund të përfitojë mandatin e anëtarit të këshillit për këtë legjislaturë.

Nga shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson se kandidati për anëtar këshilli, z. Euland Haki Daja, referuar pikës 3, shkronjës “ç”, Kreut III të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, nenit 2, pika 1, shkronja “a” dhe nenit 4, pika 1 e ligjit 138/2015 është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes ose emërimit në funksion publik.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 1, pika 2, shkronja “a” dhe neni 4, pika 1 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.

Data: 9.2024 Nr:
Ora:



Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Euland Haki Daja, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike”

138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S :

1. Ndalimin për të ushtruar funksionin publik të z. Euland Haki Daja, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, i propozuar nga Partia Demokratike, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 9.2024 Nr:
Ora:



Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Euland Haki Daja, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike”